

DRITAN SPAHIU

**REFORMA ARSIMORE E REALIZUAR NË PERIU DHËN
E MBRETËRISË SHQIPTARE
(1928 – 1939)***

Rilindasit tanë të mëdhej, që demonstuan një shkallë të lartë idealizmi për të zgjuar dhe ngritur lart ndërgjegjen kombëtare, ëndëruan dhe punuan për shkollën shqiptare, për organizimin dhe mbarëvajtjen e saj. Ata ishin të bindur se ringritja e shtetit shqiptar mbas qindra vitesh robërie do të sigurohej jo vetëm me pushkë por edhe me penë. Shkolla kombëtare shqiptare ku mësimi dhe edukimi i brezit të ri do të bëhej në gjuhën tonë të bukur do të shërbente si institucioni themelor fillestar për të përgatitur armatën e intelektualëve që do të drejtonin shtetin e ri shqiptar. Ajo do të kishte si tipar themelor edukimin patriotik të nxënësve, duke siguruar kështu bazat për mobilizimin e tyre të mëvonshëm e të suksesshëm që në vendin tonë të krijohet shteti i ri i shqiptarëve në familjen e madhe të vendeve europiane. Shkolla jonë do të mësonte të rinjve shqiptarë gjuhën tonë që na mban të bashkuar dhe na vllazëron. Ajo duhej të ishte laike, e shkëputur nga kleri fetar dhe ndikimi i tij, që mund të sillte përçarje në kushtet e vendit tonë ku kishim tri besime të ndryshme fetare.

Këto ishin kërkesat e rilindasve tanë të nderuar për shkollën kombëtare shqiptare. Ideat e tyre filluan të realizoheshin menjëherë pas Lidhjes së Prizrenit, kur u themelua Shoqëria Letrare e Stambollit (1879). Kjo shoqëri pati si program bazë të saj përhapjen e mësimit e të shkrimit të gjuhës shqipe dhe njëkohësisht zgjimin e ndjenjës kombëtare për shqiptarët si një popull i lashtë, fisnik e autokton në siujdhesën Ballkanike. Vepra e saj e parë, Abetarja e Stambollit, u bë libri i parë i shkollave të para që filluan të hapeshin në Shqipëri, megjithëse në fillim ato u hapën në mënyrë klandestine sepse qeveria otomane nuk lejonte mësimin në gjuhën shqipe. Kjo gjendje vazhdoi deri me ardhjen e xhon- turqve (1908), të cilët shpallën liri mendimi dhe shkollimi në gjuhët e tyre për popujt e ndryshëm të Perandorisë Osmane. Duke përfituar nga ky rast nacionalistët e shquar shqiptarë intensifikuan punën për përhapjen e

* Kumtesë e mbajtur në Konferencën Shkencore Ndërkombëtare me temë: “Monarkia Shqiptare, 1928-1939”, organizuar nga Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë, Muzeu Historik Kombëtar, Tiranë, 1 shtator 2008.

ideve patriotike dhe u kujdesën për futjen e mësimit të gjuhës shqipe në ato pak shkolla ekzistuese si dhe për hapjen e shkollave të reja ku mësimi do të zhvillohej në gjuhën tonë amtare. Në këtë periudhë është hapur Normalja e Elbasanit (1909), shkolla e parë e mesme në gjuhën shqipe, e cila do të përgatiste mësuesit e shkollave që do të hapeshin në Shqipëri në pragun e shpalljes së Pavarësisë. Por veprimet e xhon turqve të kryera pas vitit 1910 çuan në mbylljen e këtyre shkollave.

Me shpalljen e Pavarësisë dhe formimin e Qeverisë së përkohshme të kryesuar nga Ismail Bej Vlora, në kabinetin e të cilit bënte pjesë edhe Ministria e Arsimit, e drejtuar nga Luigj Gurakuqi, zhvillimi i edukimit dhe shkollimit të të rinjve shqiptar mori impulse dhe zhvillime të mbara. Fryma e optimizmit për të ngritur një sistem arsimor kombëtar filloi të japi frytet e para: u çelën shkolla të reja në qytete e fshatra ku mësimit zhvilloheshin në gjuhën tonë. Por ky aktivitet fatkeqësisht nuk zgjati shumë. Rebelizmat e periudhës së Luftës së Parë Botërore e shkatërruan këtë fillim të mirë.

Me pushtimin e territoreve shqiptare nga ushtritë e huaja, austro-hungareze, italiane dhe frenge (në vitet 1916 – 17), sistemi arsimor në vendin tonë hyri në një fazë tjetër. Duke qenë të interesuar për të rritur ndikimin e tyre në Shqipëri ata u interesuan për zgjerimin e arsimit dhe hapjen e shkollave të reja. Dhe në fakt u hapën shumë të tilla, por mungonin mësuesit, ata që do të realizonin detyrën e madhe të shkollimit dhe të edukimit të nxënësve. Por megjithë këtë arsimit shqiptar i asaj periudhe nuk mundi të realizonte detyrën parësore, si arsim kombëtar, sepse nuk kishte një drejtim të përbashkët. Në zonën e pushtuar nga austriakët përkatësisht shkollat vepronin sipas programit të shkollave austriake, kurse në zonat e tjera zbatoheshin programi italian dhe francez.

Kjo gjendje mori fund me formimin e Qeverisë së dalë nga Kongresi i Lushnjës (1920). Ministria e Arsimit të kësaj qeverie u përball me dy probleme madhore:

- **Njësimi (unifikimi) i tipit të shkollave, programeve dhe teksteve të tyre si dhe organizimi arsimor në vetvete** për të mënjanuar drejtimet krejt të ndryshme me njëri tjetrin dhe me nevojat e arsimit tonë kombëtar në përgjithësi.

- **Niveli i dobët i cilësisë së mësimit dhe edukimit në shkollat ekzistuese**, i cili vinte si rezultat i mungesës së mësuesve të kualifikuar; për këtë arsye këto shkolla shërbenin në fakt më shumë si kurse kundër analfabetizmit dhe jo si vatra të mirëfillta edukimi, për të dhënë dije dhe kulturë.

Kongresi arsimor i mbajtur në verën e vitit 1920 vendosi njësimin (unifikimin) e shkollave fillore dhe programeve e teksteve të tyre, duke i dhënë njëherazi arsimit frymën kombëtare. Për përmirësimin e punës në shkollë u

nevojën të mbylleshin disa shkolla që më shumë sillnin dëm se sa dobi, të cilat u rihapën më vonë, kur u përmirësua cilësia e kuadrit arsimor me masat e marra për kualifikimin e tij. Në këtë periudhë bie në sy kujdesi i madh i Ministrisë të atëhershëm të Arsimit Rexhep Mitrovica për forcimin e shkollës kombëtare shqiptare e për ta bërë atë një **“tempull kulture e qytetnije”**¹, siç thoshte ai. Këtij qëllimi madhor i shërbyen edhe kongreset arsimore që u mbajtën në Tiranë në verën e viteve 1922 dhe 1924. Në këto kongrese u trajtuan problemet e programeve shkollore, ku u kërkua që këto programe duhet të ishin unike për të gjitha shkollat e të njëjtit nivel si dhe problemet e forcimit të frymës kombëtare e patriotike në shkolla. Gjithashtu u diskutua me përgjegjësi të madhe që shkollat shqiptare që funksiononin dhe të rejat që do të hapeshin duhej të ishin laike, të lira nga sundimi i frymës fetare në to. Në këtë periudhë e në vijim u rrit ndjeshëm numri i shkollave të reja fillore e të mesme si dhe profesionale që u hapën nëpër Shqipëri. Ajo që bie në sy ishte hapja gjithnjë e më e madhe edhe e shkollave të huaja, sidomos në Shqipërinë e Jugut. Duke përfutuar nga deklarata e vitit 1921 me të cilën shteti shqiptar angazhohej para Lidhjes së Kombeve se do të respektonte të drejtën e pakicave kombëtare për shkollim në gjuhën amtare, minoriteti grek hapi shumë shkolla private në jug. Këto shkolla që financoheshin nga organizata shoviniste greke në vend që të ishin institucione mësimi dhe edukimi të shtetit shqiptar u bënë qendra të një propogande shumë të rrezikshme antishqiptare. Puna kishte arritur deri aty sa në mjaft prej këtyre shkollave gjuha shqipe nuk mësohej fare. Në shkollat private të minoritetit grek punonin mësues që e dinin shumë pak shqipen, pa nënshtetësi shqiptare dhe pa emërimin në këtë detyrë nga qeveria shqiptare. Për më tepër një pjesë e madhe e këtyre mësuesve merrnin rroga nga organizma greke të panjohura zyrtarisht në Shqipëri. Për këtë arsye një pjesë e mirë e programit mësimor e në disa raste i tërë procesi mësimor në këto shkolla bëhej në gjuhën greke, në vend që të bëhej në gjuhën shqipe. Kuptohet që edhe tekstet mësimore që përdornin këto shkolla nuk mund të edukonin frymë kombëtare, siç kërkohet në atë kohë. Qeveritë shqiptare që erdhën pas Kongresit të Lushnjës trashëguan mungesën e theksuar të kuadrit arsimor dhe rrjedhimisht edhe dobësitë e organizimit të drejtimit dhe të kontrollit të punëve në shkolla; nga kjo gjë përfutuan qarqet shoviniste greke që financonin shkollat e minoritetit, të cilat intensifikuan këtë veprimtari abuzive dhe të rrezikshme. Jani Minga si inspektor i arsimit në zonën e Gjirokastrës (1925) konstatonte me hidhërim se: *“gjendja e shkollave grekofone private prej pikëpamjes kombëtare, me përjashtim të disave fare të pakta, ishte e vajtueshme “.. Ai pohonte se ato shkolla nuk ishin veçse kazerma me ushtarë aktiv pa uniformë të ideologjisë grekomadhe, që i dërgoheshin dërgatës së tyre apostolike në*

¹ Revista *Shkolla e Re*, Tiranë, Nr.12, viti 1921

Janinë.² Prandaj ai kërkoi mbylljen e këtyre shkollave private të minoritetit grek dhe kalimin e tyre nën drejtimin e shtetit shqiptar.

Në atë kohë filluan të hapen edhe shkolla të tjera të huaja, si italiane dhe shkolla private amerikane, të cilat punonin me programet e tyre dhe rrjedhimisht nuk mund të edukonin fëmijët dhe të rinjtë shqiptarë me frymën kombëtare, që ishte detyra primare e arsimit tonë. Krahas tyre kudo në territorin shqiptar gjejmë edhe shkolla private fetare, ku mbizotëronte plotësisht edukimi fetar dhe jo ai laik dhe qytetar. Kjo gjë ishte më e theksuar sidomos për shkollat që mbante kleri katolik, i cili kishte ndikim të fuqishëm në jetën shoqërore.

Pra kjo ishte gjendja e arsimit shqiptar 80 vjet më parë kur në Shqipëri u vendos që si formë qeverisje të jetë Mbretëria Shqiptare me L.M.T. Ahmet Zogu në krye të saj.

Nga tabloja që paraqitëm duket qartë se aspiratat e kombit shqiptar të shprehura fare qartë nga Rilindasit tanë të mëdhenj për një arsim kombëtar, të njësuar dhe laik, që u përgjigjeshin më së miri detyrave të rëndësishme të edukimit të të rinjve shqiptarë, nuk mund të realizoheshin kurrësesi po të lejohej që sistemi arsimor të vazhdonte të ecte në këtë rrugë. Duhej kryer një reformim i plotë dhe cilësor i tij. Për këtë ishte bindur plotësisht edhe vetë Mbreti Zogu I, i cili mendonte se Shqipërisë tashmë i duhej një sistem shkollor i njësuar (unik) dhe laik, ku vetëm shteti do të kishte të drejtën e plotë të kontrollit për cilësinë e shkollimit dhe të edukimit, pa e ndarë këtë detyrë me askënd tjetër, qoftë ky person privat apo organizëm i huaj. Vetëm kështu shteti do të ishte garant i sovranitetit kombëtar, duke e bërë shkollën një vatër të sigurtë për edukimin e njëtrajtshëm të fëmijve dhe të rinjve të popullit shqiptar, që ushtronte 3 besime të ndryshme fetare. Reformimi i arsimit do t'i jepte shkollës detyrën e forcimit të ndërgjegjes kombëtare, që të rinjtë tanë të ishin krenar që janë Shqiptar, të donin gjuhën tonë të bukur dhe njëkohësisht puna në shkollë të mos linte shteg për mashtrime që mundoheshin të bënin të huajt me qëllimet e tyre të qarta shoviniste.

Për ta realizuar reformën në arsim Mbreti Zogu I në fillim këtë detyrë ia besoi Hilë Mosit, një luftëtar i shkëlqyer i çështjes kombëtare, një intelektual i mirëfilltë. Që në ditët e para si Ministër i Arsimit ai filloi përpjekjet e tij për krijimin e një sistemi të plotë arsimor kombëtar, që shkolla shqiptare të jetë e njësuar dhe laike. Ai shprehej prerazi dhe qartë se: ***“do të adoptojmë një program unik e methodik, në lidhni harmonike me gjuhën, doket, historin’ e gjeografinë e kombit shqiptar. Gjith ashtu edhe shtetit, që asht udhëheqësi i popullit do t’i sigurojmë një tagër e kontrollim ma të rranjosun në jetën arsimore, që të mos të rrisim një djelmëni aq tepër me ndjenja materiale e***

² Po aty.

afekt nga sëmundjet shpirtnore, por plot me karakter të shëndoshët dhe abnegacion për shoqni e komb të vet".³

Duke shpallë thelbin e programit të reformës arsimore Ministri Hilë Mosi deklaronte se: *"baza e edukatës kombëtare asht e duhet të jetë: me formue karaktere të shëndoshët aktiv e optimista! Me tjera fjalë me formue djelmosha, që tue pasë besim në fuqin'e vet, të munden me i siguruem familjes edhe kombit të vet një ardhmëni ma të lumtun!"*⁴.

Në verën e vitit 1931 u mblodh një komision për të diskutuar platformën e reformës arsimore që duhej kryer. Mbas analizës që i bëri punëve në shkollat që vepronin në atë kohë në Shqipëri dhe sistemit arsimor në përgjithësi, Ministri Hilë Mosi i paraqiti Mbretit programin e tij për kombëtarizimin e arsimit, për njësimin e programeve mësimore në shkollat filllore dhe të mesme, në mënyrë që nxënësit të merrnin njohuri të njëjta dhe tu sigurohej atyre niveli kulturor i barabartë. *Ai i kërkonte Mbretit që në ligjin e ri të arsimit, në përputhje me Statutin Themeltar të Shtetit, të futeshin dispozita të veçanta që të garantonin që vetëm Shteti të kishte të drejtën të hapte dhe të mbante shkolla fillore.*⁵ Këto kërkesa të Ministrin Hilë Mosi u vunë në bazën e dekret ligjit të 14 Shtatorit të vitit 1932. Ato përbënin thelbin e reformimit të parë të arsimit shqiptar, si dhe përpjekjen e parë serioze për ta vënë arsimin tonë në shinat e arsimit modern, europiano-perëndimor, siç aspirohej nga elita intelektuale e asaj kohe që po formohej me shpejtësi.

Përpjekjet reformuese të Ministrin Hilë Mosi u ndeshën me kundërshti të forta dhe zemërim të madh sidomos nga drejtuesit e shkollave private të klerit katolik të Shkodrës, të cilat u shprehën fare qartë në faqet e revistës "Hylli i Dritës" (shih artikujt "Rryma të reja arsimore" dhe "Letër e hapur z. Hilë Mosit" botuar përkatësisht në numrat 10 dhe 12 të vitit 1932 të "Hyllit të dritës"). E megjithatë Ministri Hilë Mosi ishte i vendosur në pikëpamjen e tij se: *"..të drejtën dhe detyrën e edukimit, mbas etikës së tij, shteti nuk duhet t'ia lajë askujt, për pa heqë dorë prej superioritetit të vet"*⁶. Ai gjithashtu ishte i bindur plotësisht se: *"shkolla duhet të kujdeset me forcue dhe me rranjosë sa ma fort në shpirtin e fëmijës ato njoftime të domosdoshme të moralit njerzor, të përbashkëta për të gjitha doktrinat dhe të nevojshme për të gjithë njerzit e qytetnuem: moralin laik."*⁷

Mbreti Zogu I e ndiqte me kujdes shumë të madh problemin e arsimit dhe ishte i bindur se arsimimi dhe edukimi i brezit të ri është problemi më madhor i

³ Iljaz Gogaj, *Mirash Ivanaj, Personalitet i Shquar i Universit Shqiptar*, Tiranë: 2004, f. 99.

⁴ Revista *Besa*, Nr. 4, Nandor 1932.

⁵ *Po aty*.

⁶ Citohet sipas: I. Gogaj, *vep. e për.*, f.99

⁷ Revista *Edukata e Re*, Tiranë, Prill 1931.

Shqipërisë, prandaj u bë iniciatori i një reforme të thellë e të plotë arsimore. Këtë detyrë të vështirë ai ia besoi intelektualit të shkëlqyer e patriotit të madh e me bindje të thella republikane Dr. Mirash Ivanajt. Kjo simbiozë disi e çuditshme e Mbretit (me pikëpamje shumë moderne) me republikanin e vendosur dhe atdhetar dha fryte shumë të mira për arsimin shqiptar. Mbreti pati çmuar shumë punën e Dr. M. Ivanaj si mësues e drejtor i Gjinnazit të Shkodrës që për një periudhë shumë të shkurtër, vetëm 2-3 vjeçare, e ngriti këtë institucion në nivelin e shkollave të mesme europiane; ai vlerësoi përgatitjen e tij të shkëlqyer intelektuale: M. Ivanaj në vitin 1923 ishte kthyer nga Universiteti “La Sapienza” i Romës me dy diploma të vlerësuara maksimalisht e me Cum Laude, të mbrojtura në fushën e Letërsi – Filozofisë si dhe në Drejtësi; por mbi të gjitha Mbreti vlerësoi te Dr. M. Ivanaj patriotizmin e tij të flakët dhe përkushtimin e tij të plotë për çështjen kombëtare.

Nga ana e tij M. Ivanaj, i mbrojtur me idetë republikane në një nga universitetet më të mira të Europës, pranoi me kënaqësi të bashkëpunojë me qeverinë e Mbretit, duke pasur besim të plotë te Mbreti Zogu I si një burrë shteti me cilësi të larta dhe si një dorë e fortë që i duhej Shqipërisë.

Me të marrë detyrën e Ministrit të Arsimit, Dr. M. Ivanaj hartoi një raport që do t’ia paraqiste Mbretit, ku parashtrroi me argumenta bindëse domosdoshmërinë e reformimit sa më të shpejtë të sistemit arsimor dhe edukativ me synimin e qartë për t’i dhënë shkollës shqiptare:

1. Frymën kombëtare

2. Karakterin qytetar – laik

3. Pavarësinë, duke mënjanuar ndërhyrjen e rrezikshme të të huajve dhe organizmave private, kryesisht të qarqeve shoviniste greke dhe italiane, në punët e shkollës dhe të edukimit të rinisë shqiptare.

Ministri M. Ivanaj argumentonte se reforma e thellë dhe e plotë arsimore duhej kryer sa më shpejt e pa humbur kohë, sepse edukimi i rinisë shkollore po bëhej pa kontrollin dhe ndikimin e nevojshëm të shtetit, duke i dhënë shkas propogandës shoviniste të të huajve që kishin hapur dhe po financonin shkollat private për të helmatisur me ideologjitë e tyre antishqiptare djelmërinë tonë. Problemin e edukimit me frymë kombëtare ai e konsideronte të një rëndësie parësore sepse Shqipëria kishte vuajtur nga pushtimet e huaja prej shekujsh, të cilat kishin krijuar mangësi të mëdha në fushën e edukatës qytetare dhe trashëgimisë tonë të lashtë historike e gjuhësore. Ai argumentonte gjithashtu se eliminimi i ndërhyrjes së huaj në punët e arsimit shqiptar duhej bërë me një operacion radikal, sepse kjo gjë nuk mund të bëhej me ligje të pjesshme për të korrigjuar rregulloret e veprimt të këtyre shkollave. Arsytet e një operacioni të tillë diktoheshin nga fakti se shkollat e huaja private kishin fituar tashmë një autoritet dhe pavarësi të tillë që ishte shumë e vështirë t’u nënshtroheshin ligjeve kufizuese të Ministrisë së Arsimit. Eliminimi i ndërhyrjes së huaj dhe

asaj private si dhe fetare në shkollat shqiptare diktohej nga fakti se këto shkolla kishin si qëllim kryesor të tyre propogandën e pastër politike e shoviniste (grekët dhe italianët) në dëm të interesave kombëtare të Shqipërisë, si dhe paralizimin e edukimit qytetar e laik, duke forcuar deri në dominim të plotë edukatën fetare.

Në përfundim të raportit të tij **ministri M.Ivanaj i parashtronte NMT Mbretit mënyrën e realizimit të reformës arsimore, duke kërkuar para së gjithash që të ndryshohej neni 206 i Statutit të Shtetit Shqiptar që lejonte çeljen e shkollave të huaja e private në Shqipëri.** Ai argumentonte se kjo kërkesë e fortë do të kishte efekte shumë të mira si brenda ashtu edhe jashtë Shqipërisë *“sepse do të dëftoi se kemi vullnetin të piqemi shtetësisht.”*⁸

Së dyti ai kërkonte të përjashtohej ndërhyrja direkte e Italisë në arsimin shqiptar që realizohej me anën e nëpunësve italian që kishin krijuar zyra paralele me ato të Ministrisë së Arsimit dhe që kishin të drejta drejtimi të pavarura nga shteti ynë. Ministri sugjeronte që në qoftë se e kërkojnë interesat e shtetit tonë mund të lihej vetëm një organizator italian për shkollat profesionale me cilësinë e këshilltarit teknik, pa asnjë të drejtë vendimi, i cili mund të merrej me kontratë që mund të përsëritej vit pas viti.

Thelbin e rëndësisë së reformës arsimore Ministri M. Ivanaj e shprehte me këto fjalë lapidare: “Shteti ynë si çdo shoqni e organizueme, ka disa interesa që duhen vu në vendin e parë përpara çdo interesi të privatëve: në këto interesa jo ma pak se monopolizimi i ushtrisë dhe i drejtësisë, hyn edhe monopolizimi nga ana e shtetit edhe i edukimit të popullit, pse sigurimi i njëj shteti dhe zhvillimi i qetë i tij, nuk mund të sigurohen me forca armate as me ligje, në kjoftë se qytetasit e tij rriten me një ndiesi përbuzje kundrejt shtetit dhe ligjeve dhe me një egoizëm rrënuese antishoqnore e antiatdhedashëse”. dhe vazhdonte më tej se: *“rikrijimi i një populli mund të realizohet vetëm prej vullnetit të Nalt Madhnisë s’uaj që si ka ditë me krijue shqiptarisht Shqipërinë don me formue shqiptarët shqiptarisht”*.

Mbreti e miratoi menjëherë reformën e propozuar dhe kështu u hap rruga për të kërkuar miratimin e saj nga Parlamenti Shqiptar. **Me propozimin e 45 deputetëve Parlamenti u mblodh më 10 Prill 1933, pra 75 vjet më parë, për të dëgjuar e diskutuar për platformën e Ministrit M. Ivanaj për reformën arsimore.** Për t’i bindur deputetët të votonin ndryshimet në Statutin Shtetëror e për t’i hapë kështu rrugën realizimit të reformës Ministri do të theksonte se:

1. Shkolla jonë duhet të jetë kombëtare sepse: *“.. asht mirë të kuptohet prej gjithkujt njëherë e mirë e përgjithmonë”* se shteti shqiptar nuk mund të hiqte dorë nga edukata e brezit të ri, nga përgatitja *“...totale absolute e tanë e pandame e qytetarëve të ardhshëm, tue u dhanë një shpirt, një mendim, një*

⁸ Po aty, Dhjetor, 1931.

⁹ Citohet sipas: I. Gogaj, *vep. e përm.*, f. 104.

ndiesi, një të vetmin moral, pa ortak e ndihmësa”, të cilët duke harruar moralin shtetëror dhe edukatën kombëtare e bazonin edukatën “...mbi moral egoist, problematik antagonist zhatërrues të unitetit të racës shqiptare dhe stabilitetit të shtetit shqiptar”.¹⁰

Lidhur me këtë çështje Ministri i Arsimit u kujtonte deputetëve të Parlamentit se populli shqiptar gjatë historisë së tij ka zhvilluar lufta të shumta kundër pushtesve të huaj për të shpëtuar identitetin kombëtar e për të ruajtur gjuhën e bukur shqipe nga asimilimi. Për të ruajtur e për të zhvilluar më tej identitetin tonë Ministri argumentonte se tashmë duhen bërë përpjekje të mëdha për të zhvilluar arsimin dhe kulturën ku rolin kryesor do ta luante “...edukata kombëtare e bazueme mbi gjuhë, mbi burri, mbi traditat e përbashkëta, mbi interesat e përgjithshme të popullit”¹¹.

2. Kujdesin për arsimin shteti nuk do ta ndaj me askënd, sepse eksperiencia kishte treguar se shkollat e lëna në duart e personave privat nuk kishin realizuar asnjë prej detyrave për të cilat kishin marrë lejen zyrtare ose siç thoshte Ministri M. Ivanaj “...nuk kishin dhanë ato frute që pritëshin prej saj për të mirën e popullit”.¹² Përkundrazi mësuesit që punonin në këto shkolla shikonin përfitimin financiar në dëm të nxënësve, kurse në shkollat e huaja private ata përveç kësaj zhvillonin një veprimtari jo kombëtare por shoviniste në interes të atyre organizmave të huaja që i financonin këto shkolla.

3. Shkolla jonë duhet të japë edukatë qytetare e laike sepse qëllimi i shkollës është që të formojë qytetar të lirë e me edukatë dhe formim shkencor e teknik bashkëkohor.

Këto çështje Ministri M. Ivanaj i parashtrroi me një pathos të madh para deputetëve të Parlamentit shqiptar. Dhe kështu **më 11 Prill 1933 Parlamenti miratoi në mënyrë unanime tezat e paraqitura nga Dr. M. Ivanaj për reformën arsimore të Mbretnisë Shqiptare.** Kjo ishte një ditë e madhe në historinë e arsimit shqiptar. Me argumentimet e Ministrit M. Ivanaj Parlamenti shqiptar ndryshoi nenet e Statutit të Shtetit. Kështu neni 206 u riformulua në formën:

Neni 206. “Mësimi dhe edukimi i shtetasve shqiptarë janë një e drejtë ekskluzive e shtetit.

Jepen vetëm ndër shkolla shtetërore shkallësh të ndryshme sipas ligjës.

Arsimi fillor për të gjithë shtetasit shqiptar është i detyrueshëm dhe jepet falas.

¹⁰ Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë (më tej: AQSh), dok. Dt. 31. 01. 1933.

¹¹ Citohet sipas: I. Gogaj, *vep. e përm.*, fq. 107

¹² AQSh, dok. dt 11. 04. 1933.

Shkollat private të çdo kategorie qofshin që kanë veprue deri më sot mbyllen.”

Neni 207. “Shkollat fetare për përgatitjen e klerit të mbajtura prej komuniteteve fetare shqiptare, janë të lira dhe rregullohen me ligje.”¹³

Mbas miratimit të Parlamentit për ndryshimet në Statutin e Shtetit, Mbreti i shpalli ato me një dekret të veçantë.

Reforma arsimore e Mbretërisë Shqiptare që u miratua, i dha arsimit shqiptar karakterin kombëtar të padiskutueshëm, e bëri sistemin tonë arsimor qytetar e laik dhe shtetin garantin e vetëm për të ruajtur cilësinë e punës mësimore dhe edukative të shkollës, duke mos lejuar abuzime financiare të personave privat në dëm të tyre, duke mos lejuar ndikime shoviniste e antishqiptare të organizmave të huaja që po helmonin përgatitjen e brezit tonë të ri me ideologjinë dashakeqëse e deri armiqësore për kombin shqiptar. Miratimi i reformës arsimore nuk ishte një proces i lehtë sepse u kërkuan ndryshime të neneve të Statutit Themeltar të Shtetit, të cilat nuk ndryshohen kollaj. Por në këtë rast ndryshimet nuk u bënë për qëllime të vogla politike, por për interesa madhore të kombit. Ndryshimet e bëra në Statutin e Shtetit më 11 Prill 1933 u bënë në të mirë të arsimit kombëtar, sepse dihet se sa më i mirë do të jetë niveli arsimor i një vendi sot aq më e mirë do të jetë e ardhmja e tij nesër. Ndryshimet që u bënë në Statut kishin pikërisht këtë synim, rrjedhimisht vetë Statuti u saktësua dhe u përmirësua. Kjo punë e nderonte Statutin dhe ata që e përmirësuan atë, deputetët që votuan, Ministrin që i kërkoi këto ndryshime dhe Mbretin e shqiptarëve që i inspiroi dhe i dekretoi.

Reforma arsimore që u përgatit nga Ministria e Arsimit ishte e plotë dhe e thellë. Me qëllimet e mësipërme reforma përfshiu të gjitha hallkat e sistemit mësimor dhe edukativ; ajo u përgatit gjatë viteve 1933-‘34 dhe **Dekret Ligja Organike e Arsimit** u shpall në shtator të vitit 1934. Ky dekretligj përmban dispozitat ligjore mbi:

- **Organizimin e Ministrisë së Arsimit, si dhe komisionin e teksteve,**
- **Arsimin fillor,**
- **Arsimin e mesëm,**
- **Edukatën kombëtare dhe Federatën Sportive Shqiptare,**
- **Bursat kombëtare.**

Dispozitat Ligjore mbi Arsimin në Shqipëri mund t’i gjeni të botuara në mënyrë të plotë në broshurën “Shqipëria më 1937”, vëllimi i parë, botimet e komisionit të kretimeve të 15 vjetorit të vetëqeverimit 1912 – 1937.

Në Dekret Ligjën Organike të Arsimit trajtohen problemet e të gjitha hallkave të sistemit arsimor, kështu:¹⁴

¹³ *Po aty.*

¹⁴ *Po aty.*

a. për arsimin fillor përcaktohet qartë dhe saktë qëllimi i shkollës, detyrimi shkollor, zgjedhja e personelit mësimor dhe detyrat për përmirësimin e cilësisë së punës së tij, shërbimi mjekësor në shkolla si dhe kontrolli i punës së shkollës.

b. Për arsimin e mesëm përcaktohet qëllimi i tij, llojet e shkollave të mesme, koha e viteve të studimit kontrolli i punës në këto shkolla që do të kryhet drejtpërdrejt nga Ministria e Arsimit, pranimi i nxënësve në këto shkolla dhe provimet që duhet të japin ata për të marrë diplomën.

c. Për edukatën kombëtare theksohet se: *...”për sa i përket mbikqyrjes dhe zhvillimit sportiv e artistik ndaj djelmënisë shkollore e jashtëshkollore ngarkohet Federata Sportive Shqiptare e krijuar pranë Ministrisë së Arsimit.”*

d. Për bursat kombëtare: përcaktohet qëllimi i dhënies së bursave për nxënësit e zonave ku nuk mund të hapen shkolla ose kur familjarët e tyre nuk kanë mundësi financiare për të përballuar shkollimin e fëmijëve të tyre. Gjithashtu përcaktohen edhe kriteret për të dhënë bursa për studentët që do të studiojnë jashtë shtetit.

Së fundi Dekret Ligja autorizon Ministrinë e Arsimit *me mbajtje një shkollë artesh të bukura me program të caktuar, si dhe me ndihmë financiarisht shoqëritë sportive, letrare e artistike dhe me ndërtue stadiume e fusha sportive.*

Zbatimi i reformës arsimore të Mbretërisë Shqiptare u konkretizua me shtetëzimin e shkollave, duke mbyllur shkollat fillore private të pavarura si dhe ato të komuniteteve fetare; kështu u mbyllën gjithashtu edhe shkollat e huaja private për shqiptarët si dhe shkollat private të komunitetit minoritar grek. Në arsimin e mesëm reforma mbylli gjimnazet jezuit dhe françeskan në Shkodër, shkollën femërore të stigmatinëve në Shkodër, shkollën normale femërore në Korçë, Institutin privat femëror “Naim Frashëri” në Tiranë si dhe Institutin privat Kyrias në Kamëz. Në vend të tyre u krijuan në Tiranë: Instituti femëror “Nëna Mbretneshë” dhe në Korçë shkolla femërore qytetëse 4 vjeçare.

Në arsimin teknik si rezultat i zbatimit të reformës u shtetëzuan shkolla teknike “H.Fultz”, shkollat profesionale italiane, të cilat u zëvendësuan me shkolla teknike qytetëse sipas nevojave të rajoneve ku ato vepronin. Kjo gjë ndodhi si rezultat i faktit se drejtuesit e këtyre shkollave nuk pranuan që të punonin nën autoritetin e Shtetit Shqiptar dhe të kontrolloheshin prej tij.

Kjo ishte reforma arsimore e Mbretërisë Shqiptare. Ajo tashmë duhej përballuar dhe realizuar me sukses nga masa e arsimtarëve. Mbreti Zogu I duke vlerësuar lart misionin e reformës shprehej: *“Ky mision i naltë, i ndiemun prej çdo shqiptari përmbushet me misionin kombëtar të mbështetun mbi njënjshmëninë e mendësive, mbi gjuhë, mbi tradita dhe aspiracionet e përbashkëta të Kombit. Këtë mision ua besojmë arsimtarëve”,* më tej Mbreti

vazhdon: ***“Vetëm kështu shkolla shqiptare bahet tempulli i përbashkët i popullit dhe djalërisë, ku duhej të zhvilloheshin e të nderoheshin vlerat e Kombit për lumturinë e atdheut”.***¹⁵

Reforma arsimore e Mbretërisë Shqiptare e vuri arsimin dhe edukimin e brezit tonë të ri mbi baza bashkëkohore, të ngjashme me ato të sistemit europian. Shkolla jonë mori tiparet e duhura të një shkolle që jep dije dhe kulturë qytetare; kjo reformë e shndërroi shkollën tonë në një vatër të shenjtë e të respektuar, ku do të përgatiteshin qytetar dinjitoz e me viryete të larta, që i meritonte shqiptari.

Reforma arsimore e Mbretërisë Shqiptare ishte e plotë sepse preku të gjitha hallkat e sistemit arsimor dhe edukativ; ajo u përgatit me një përkushtim të veçantë dhe për nga cilësia dhe intelektualizmi i trajtimit të problemeve të shkollës ajo mbetet si një ndër reformat më të mira të arsimit shqiptar.

Unë mendoj se kjo reformë ka rëndësi historike jo vetëm për kohën kur u realizua, por edhe për kohën e sotme. Në vitin 1991 ne ndërruam sistemin politik, duke kaluar nga një regjim i egër komunist në një rend të lirë e demokratik. Ky ndryshim politik duhej shoqëruar para së gjithash me një reformim të thellë e të plotë të sistemit arsimor, që t’i përgjigjej sa më mirë situatës së re politike e shoqërore të Shqipërisë. Duheshin përcaktuar qartë dhe saktë synimet e të gjitha etapave të arsimit, detyrat përkatëse të shkollave dhe mënyrat e realizimit sa më efektive dhe sa më frytdhënëse të tyre për shkollimin dhe edukimin e brezit tonë të ri. E në këtë aspekt reforma arsimore e realizuar në kohën e Mbretërisë Shqiptare mendoj se mund të merret si një model shumë i mirë.

¹⁵ “Shqipënia me 1937”, Botimet e komisionit të kremtimeve të 25-vjetorit të vetqeverimit, 1912-1937.

